

In the Space of Not Many Years

By Elder David A. Bednar
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Në Hapësirën e Jo Shumë Viteve

Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

October 2024 general conference

If we are not faithful and obedient, we can transform the God-given blessing of prosperity into a prideful curse that diverts and distracts us.

My beloved brothers and sisters, sitting on the stand today, I have watched this Conference Center fill up three times, for the first time since COVID. You are devoted disciples of Jesus Christ who are eager to learn. I commend you for your faithfulness. And I love you.

Ezra Taft Benson served as the President of The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints from November 1985 until May 1994. I was 33 years old when President Benson became the President of the Church and 42 when he passed away. And his teachings and testimony influenced me in profound and powerful ways.

One of the hallmarks of President Benson's ministry was his focus upon the purpose and importance of the Book of Mormon. He emphasized repeatedly that "the Book of Mormon is the keystone of our religion—the keystone of our testimony, the keystone of our doctrine, and the keystone in the witness of our Lord and Savior." He also often emphasized teachings and warnings about the sin of pride found in this latter-day testament of Jesus Christ.

A particular teaching by President Benson greatly impacted me and continues to influence my study of the Book of Mormon. He said:

"The Book of Mormon ... was written for our day. The Nephites never had the book; neither did the Lamanites of ancient times. It was meant for us. Mormon wrote near the end of

Nëse nuk jemi besnikë e të bindur, ne mund ta shndërrojmë bekimin e begatisë të dhënë nga Perëndia në një mallkim kryelartë që na bën të devijojmë dhe të shpërqendrohemi.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, i ulur në podium sot, e kam parë këtë Qendër të Konferencave të mbushur tri herë, për herë të parë që nga COVID-i. Ju jeni dishepuj të përkushtuar të Jezu Krishtit që keni shumë dëshirë për të mësuar. Ju lavdëroj për besnikërinë tuaj. Dhe ju dua.

Presidenti Ezra Taft Benson shërbeu si Presidenti i Kishës së Jezu Krishtit të Ditëve të Mëvonshme nga nëntori i vitit 1985 deri në maj të vitit 1994. Isha 33 vjeç kur Presidenti Benson u bë Presidenti i Kishës dhe 42 vjeç kur ai ndërroi jetë. Mësimet dhe dëshmia e tij ndikuan tek unë në mënyra të thella e të fuqishme.

Një nga tiparet dalluese të shërbesës së Presidentit Benson, ishte përqendrimi i tij te qëllimi dhe rëndësia e Librit të Mormonit. Ai e theksoi në mënyrë të përsëritur se Libri i Mormonit "është guri kyç i besimit tonë – guri kyç i dëshmisë sonë, guri kyç i doktrinës sonë dhe guri kyç në dëshmimin tonë për Zotin dhe Shpëtimtarin tonë". Ai i theksoi shpesh mësimet dhe paralajmërimet rreth mëkatit të kryelartësisë që gjenden në këtë dëshmi të ditëve të mëvonshme për Jezu Krishtin.

Një mësim i veçantë nga Presidenti Benson ndikoi jashtë mase tek unë dhe vazhdon të ndikojë te studimi që i bëj Librit të Mormonit. Ai tha:

"Libri i Mormonit ... u shkrua për kohën tonë. Nefitët nuk e patën kurrë librin; as lamanitët e kohëve të lashta. Ai ishte paracaktuar për ne. Mormoni shkroi afër fundit të qytet-

the Nephite civilization. Under the inspiration of God, who sees all things from the beginning, [Mormon] abridged centuries of records, choosing the stories, speeches, and events that would be most helpful to us.”

President Benson continued: “Each of the major writers of the Book of Mormon testified that he wrote for future generations. ... If they saw our day, and chose those things which would be of greatest worth to us, is not that how we should study the Book of Mormon? We should constantly ask ourselves, ‘Why did the Lord inspire Mormon ... to include [this account] in his record? What lesson can I learn from [this admonition] to help me live in this day and age?’”

President Benson’s statements help us to understand that the Book of Mormon is not primarily a historical record that looks to the past. Rather, this volume of scripture looks to the future and contains important principles, warnings, and lessons intended for the circumstances and challenges of our day. Hence, the Book of Mormon is a book about our future and the times in which we do now and will yet live.

I pray for the assistance of the Holy Ghost as we now consider relevant lessons for us today from the book of Helaman in the Book of Mormon.

The Nephites and the Lamanites

The record of Helaman and his sons describes a people who were anticipating the birth of Jesus Christ. The half century recounted in the scriptural record highlights the conversion and righteousness of the Lamanites and the wickedness, apostasy, and abominations of the Nephites.

A series of comparisons and contrasts between the Nephites and Lamanites from this ancient record are most instructive for us today.

“The Lamanites had become, the more part of them, a righteous people, insomuch that their righteousness did exceed that of the Nephites, because of their firmness and their steadiness in the faith.

“[And] there were many of the Nephites who had become hardened and impenitent and grossly wicked, insomuch that they did reject the word of God and all the preaching and prophesying which did come among them.”

ërimet nefit. Nën frymëzimin e Perëndisë, i cili i sheh të gjitha gjërat që nga fillimi, [Mormoni] përmbledhi anale qindrvjeçare, duke zgjedhur histori, fjalime dhe ngjarje që do të ishin më të dobishmet për ne.”

Presidenti Benson vazhdoi: “Secili nga shkrimtarët e mëdhenj të Librit të Mormonit dëshmoi se ai shkroi për brezat e ardhshëm. Nëse ata e panë kohën tonë dhe zgjodhën ato gjëra që do të ishin me vlerën më të madhe për ne, a nuk është ajo mënyra se si duhet ta studiojmë ne Librin e Mormonit? Ne duhet ta pyesim veten tonë vazhdimisht: ‘Përse Zoti e frymëzoi Mormonin që ta përfshijë [këtë rrëfim] në analin e tij? Çfarë mësimi mund të mësoj nga [kjo këshillë] që të më ndihmojë të jetoj në këtë kohë dhe epokë?’”

Pohimet e Presidentit Benson na ndihmojnë të kuptojmë se Libri i Mormonit nuk është kryesisht një anal historik që sheh nga e shkuara. Përkundrazi, ky vëllim i shkrimit të shenjtë sheh nga e ardhmja dhe përmban parime, paralajmërime dhe mësim të rëndësishme që synojnë rrethanat dhe sfidat e kohës sonë. Prandaj, Libri i Mormonit është një libër rreth së ardhmes sonë dhe kohës në të cilën jetojmë dhe asaj që do të jetojmë më tej.

Lutem për ndihmën e Frymës së Shenjtë ndërsa marrim në shqyrtim tani mësim që janë me vend për ne sot nga libri i Helamanit në Librin e Mormonit.

Nefitët dhe Lamanitët

Anali i Helamanit dhe i bijve të tij përshkruan një popull që po priste lindjen e Jezu Krishtit. Gjysma e shekullit e treguar në analin e shkrimit të shenjtë e vë theksin te kthimi në besim dhe te drejtësia e lamanitëve dhe te ligësia, braktisja dhe neveritë e nefitëve.

Një sërë krahasimesh dhe ballafaqimesh mes nefitëve dhe lamanitëve nga ky anal i lashtë janë tejet udhëzuese për ne sot.

“Lamanitët, pjesa më e madhe e tyre, u bënë një popull i drejtë, kaq sa drejtësia e tyre ia kaloi asaj të nefitëve, për shkak të vendosmërisë së tyre dhe vazhdimësisë së tyre në besim.

[Dhe] kishte shumë nga Nefitët që ishin bërë të ashpër dhe të papenduar, dhe shumë të ligj, kaq sa hodhën poshtë fjalën e Perëndisë dhe të gjitha predikimet dhe profecitë që u bënë mes tyre.”

“And thus we see that the Nephites did begin to dwindle in unbelief, and grow in wickedness and abominations, while the Lamanites began to grow exceedingly in the knowledge of their God; yea, they did begin to keep his statutes and commandments, and to walk in truth and uprightness before him.

“And thus we see that the Spirit of the Lord began to withdraw from the Nephites, because of the wickedness and the hardness of their hearts.

“And thus we see that the Lord began to pour out his Spirit upon the Lamanites, because of their easiness and willingness to believe in his words.”

Perhaps the most stunning and sobering aspect of this decline into apostasy by the Nephites is the fact that “all these iniquities did come unto them in the space of not many years.”

The Nephites Turned Away from God

How could a once-righteous people become hardened and wicked in such a short period of time? How could people so quickly forget the God who had blessed them so abundantly?

In a powerful and profound way, the negative example of the Nephites is instructive for us today.

“Pride ... began to enter ... into the hearts of the people who professed to belong to the church of God ... because of their exceedingly great riches and their prosperity in the land.”

“[They] set [their] hearts upon the riches and the vain things of this world” “because of that pride which [they] ... suffered to enter [into their] hearts, which ... lifted [them] up beyond that which is good because of [their] exceedingly great riches!”

Ancient voices from the dust plead with us today to learn this everlasting lesson: prosperity, possessions, and ease constitute a potent mixture that can lead even the righteous to drink the spiritual poison of pride.

Allowing pride to enter into our hearts can cause us to mock that which is sacred; disbelieve in the spirit of prophecy and revelation; trample under our feet the commandments of God; deny the word of God; cast out, mock, and revile against the prophets; and forget the Lord our God and “not desire that the Lord [our] God,

“Dhe kështu, ne shohim se Nefitët filluan të binin në mosbesim dhe të rriteshin në ligësi dhe neveri, ndërsa Lamanitët filluan të rriteshin jashtëzakonisht shumë në njohurinë e Perëndisë së tyre; po, ata filluan të zbatonin statutet dhe urdhërimet e tij dhe të ecnin me vërtetësi dhe drejtësi para tij.

Dhe kështu ne shohim se Shpirti i Zotit filloi të largohej nga Nefitët, për shkak të ligësisë dhe të ngurtësimit të zemrave të tyre.

Dhe kështu, ne shohim se Zoti filloi të derdhte mbi Lamanitët Shpirtin e tij, për shkak të lehtësisë dhe të vullnetit të tyre për të besuar në fjalët e tij.”

Ndoshta ana më tronditëse dhe kthjelluese e kësaj të tatëpjete [që përfundoi] në braktisje nga nefitët, është fakti se “të gjitha këto paudhësi erdhën tek ata në hapësirën e jo shumë viteve”.

Nefitët u Larguan nga Perëndia

Si mund të bëhej i ngurtësuar dhe i lig një popull që dikur ishte i drejtë, në një periudhë kaq të shkurtër kohore? Si mund ta harronin njerëzit kaq shpejt Perëndinë që i kishte bekuar me aq bollëk?

Në një mënyrë të fuqishme dhe të thellë, shembulli negativ i nefitëve është udhëzues për ne sot.

“Kryelartësi[a] ... filloi të hynte ... në zemrat e njerëzve që pretendonin të bënin pjesë në kishën e Perëndisë ... për shkak të pasurive të tyre jashtëzakonisht të mëdha dhe të begatisë së tyre në tokë.”

“Zemrat [e tyre] i k[anë] vënë mbi pasuritë dhe mbi gjërat e kota të kësaj bote” “për atë kryelartësi që k[anë] lejuar të hyjë në zemrat [e tyre], që [i] ka ngritur përtej asaj që është e mirë, për shkak të pasurive [të tyre] jashtëzakonisht të mëdha!”

Zërat e lashtë prej pluhurit na përgjerojnë sot që të nxjerrim këtë mësim të përhershëm: begatia, zotërimet materiale dhe rehatiapërbëjnë një përzierje të fuqishme që mund ta shtyjë edhe të drejtin të pijë helmin shpirtëror të kryelartësisë.

Kur e lejojmë kryelartësinë të na hyjë në zemër, kjo mund të bëjë që ne të tallemi me atë që është e shenjtë, të mos besojmë në shpirtin e profecisë dhe zbulesës, t'i shkelim me këmbë urdhërimet e Perëndisë, të mohojmë fjalën e Perëndisë, t'i dëbojmë, t'i përqeshim dhe të themi fjalë të rënda kundër profetëve dhe të harrojmë

who hath created [us], should rule and reign over [us].”

Therefore, if we are not faithful and obedient, we can transform the God-given blessing of prosperity into a prideful curse that diverts and distracts us from eternal truths and vital spiritual priorities. We always must be on guard against a pride-induced and exaggerated sense of self-importance, a misguided evaluation of our own self-sufficiency, and seeking self instead of serving others.

As we pridefully focus upon ourselves, we also are afflicted with spiritual blindness and miss much, most, or perhaps all that is occurring within and around us. We cannot look to and focus upon Jesus Christ as the “mark” if we only see ourselves.

Such spiritual blindness also can cause us to turn out of the way of righteousness, fall away into forbidden paths, and become lost. As we blindly “turn unto [our] own ways” and follow destructive detours, we are inclined to lean upon our own understanding, boast in our own strength, and depend upon our own wisdom.

Samuel the Lamanite succinctly summarized the turning away from God by the Nephites: “Ye have sought all the days of your lives for that which ye could not obtain; and ye have sought for happiness in doing iniquity, which thing is contrary to the nature of that righteousness which is in our great and Eternal Head.”

The prophet Mormon observed, “The more part of the people [remained] in their pride and wickedness, and the lesser part [walked] more circumspectly before God.”

The Lamanites Turned to God

In the Book of Helaman, the increasing righteousness of the Lamanites provides a stark contrast to the rapid spiritual decline of the Nephites.

The Lamanites turned to God and were brought to a knowledge of the truth by believing the teachings in the holy scriptures and of prophets, exercising faith in the Lord Jesus Christ, repenting of their sins, and experiencing a mighty change of heart.

Zotin, Perëndinë tonë dhe të mos “dëshiroj[më] që Zoti, Perëndia [ynë] i cili [na] ka krijuar, të sundojë dhe të mbretërojë mbi [ne]”.

Ndaj, nëse nuk jemi besnikë e të bindur, ne mund ta shndërrojmë bekimin e begatisë të dhënë nga Perëndia në një mallkim kryelartë që na bën të devijojmë dhe të shpërqendrohemi nga të vërtetat e përjetshme dhe përparësitë jetike shpirtërore. Ne përherë duhet të bëjmë rojë kundër ndjesisë së ekzagjeruar e të nxitur nga kryelartësia të rëndësishme vetjake, kundër vlerësimit të gabuar të vetëmjaftueshmërisë dhe të marrjes me veten në vend të shërbimit ndaj të tjerëve.

Teksa përqendrohemi me kryelartësi te vetja, ne gjithashtu prekemi nga verbëria shpirtërore dhe humbasim shumë, shumicën ose ndoshta të gjitha gjërat që po ndodhin brenda nesh dhe përreth nesh. Nuk mund të shohim te Jezu Krishti dhe të përqendrohemi tek Ai si “shenj[a]” nëse shohim vetëm veten.

Një verbëri e tillë shpirtërore gjithashtu mund të shkaktojë që ne të largohemi nga udha e drejtësisë, të largohemi në shtigje të ndaluara dhe të humbasim. Ndërsa ne verbërisht “kthe[hemi] në udhët [tona]” dhe ndjekim devijime shkatërruese, kemi prirjen të mbështetemi tek të kuptuarit tonë, të mburremi në fuqinë tonë dhe të varemë nga urtësia vetjake.

Samuel Lamaniti e përmbloodhi shkurt largimin e nefitëve nga Perëndia: “Ju keni kërkuar gjithë ditët e jetës suaj atë që nuk mund ta kishit dot; dhe ju keni kërkuar lumturi duke bërë paudhësi, gjë e cila është në kundërshtim me natyrën e asaj drejtësie që është në Udhëheqësin tonë të madh dhe të Përjetshëm”.

Profeti Mormoni vërejti: “Shumica e njerëzve ... qëndrua[n] në krenarinë dhe në ligësinë e tyre dhe pjesa më e vogël ... ec[ën] më me kujdes para Perëndisë”.

Lamanitët u Kthyen te Perëndia

Në Librin e Helamanit, drejtësia në rritje e lamanitëve përbën një dallim të ndjeshëm me rënien e shpejtë shpirtërore të nefitëve.

Lamanitët u kthyen te Perëndia dhe u sollën në njohurinë e së vërtetës duke besuar mësimet në shkrimet e shenjta dhe ato të profetëve, duke ushtruar besim te Zoti Jezu Krisht, duke u penduar për mëkatet dhe duke përjetuar një ndryshim të madh të zemrës.

“Therefore, as many as have come to this, ye know of yourselves are firm and steadfast in the faith, and in the thing wherewith they have been made free.”

“Ye should behold that the more part of [the Lamanites] are in the path of their duty, and they do walk circumspectly before God, and they do observe to keep his commandments and his statutes and his judgments. ...

“... They are striving with unwearied diligence that they may bring the remainder of their brethren to the knowledge of the truth.”

As a consequence, the “righteousness [of the Lamanites] did exceed that of the Nephites, because of their firmness and their steadiness in the faith.”

A Warning and a Promise

Moroni declared: “Behold, the Lord hath shown unto me great and marvelous things concerning that which must shortly come, at that day when these things shall come forth among you.

“Behold, I speak unto you as if ye were present, and yet ye are not. But behold, Jesus Christ hath shown you unto me, and I know your doing.”

Please remember that the Book of Mormon looks to the future and contains important principles, warnings, and lessons intended for me and you in the circumstances and challenges of our present day.

Apostasy can occur at two basic levels—institutional and individual. At the institutional level, The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints will not be lost through apostasy or taken from the earth.

The Prophet Joseph Smith proclaimed: “The Standard of Truth has been erected; no unhalloved hand can stop the work from progressing ... ; the truth of God will go forth boldly, nobly, and independent, till it has penetrated every continent, visited every clime, swept every country, and sounded in every ear, till the purposes of God shall be accomplished, and the Great Jehovah shall say the work is done.”

At the individual level, each of us must “beware of pride, lest [we] become as the Nephites of old.”

May I suggest that if you or I believe we are sufficiently strong and stalwart to avoid the arrogance of pride, then perhaps we already are suffering from this deadly spiritual disease. Sim-

“Prandaj, të gjithë ata që kanë arritur në këtë pikë, ju e dini vetë, janë të vendosur dhe të pae-pur në besimin dhe në gjënë me të cilën ata janë bërë të lirë.”

“Shikoni se pjesa më e madhe e [lamanitëve] janë në shtegun e detyrës së tyre dhe ecin me kujdes para Perëndisë dhe përpiqen të zbatojnë urdhërimet e tij dhe statutet dhe gjykimet e tij. ...

... [Ata] po përpiqen me zell të vazhdueshëm, që të mund të sjellin mbetjen e vëllezërve të tyre në njohurinë e së vërtetës.”

Për pasojë, “drejtësia [e lamanitëve] ia kaloi asaj të nefitëve për shkak të vendosmërisë së tyre dhe të qëndrueshmërisë së tyre në besim”.

Një Paralajmërim dhe një Premtim

Moroni deklaroi: “Vini re, Zoti më ka treguar gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme në lidhje me atë që do të vërtetohet së shpejti, në atë ditë kur këto gjëra të dalin në dritë mes jush.

Vini re, unë ju flas sikur të ishit të pranishëm, por megjithatë nuk jeni akoma. Por vini re, Jezu Krishti ju ka paraqitur tek unë dhe unë i di vepërimet tuaja.”

Ju lutem, mbajeni mend se Libri i Mormonit sheh nga e ardhmja dhe përmban parime, paralajmërimet dhe mësimet të rëndësishme të synuara për mua dhe ju në rrethanat dhe sfidat e kohës sonë të tashme.

Braktisja mund të ndodhë në dy nivele bazë: në nivel institucional dhe individual. Në nivel institucional, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nuk do të humbasë nëpërmjet braktisjes apo të merret nga toka.

Profeti Jozef Smith shpalli: “Standardi i së vërtetës është vendosur; asnjë dorë mëkatore nuk mund ta ndalojë përparimin e punës; ... e vërteta e Perëndisë do të shkojë përpara me guxim, me fisnikëri dhe e pavarur derisa ajo të ketë përshkuar çdo kontinent, të ketë vizituar çdo rajon, të futet në çdo vend dhe të jetë dëgjuar nga çdo vesh, derisa qëllimet e Perëndisë të përmbushen dhe Jehova i Madh të thotë se puna u krye”.

Në nivel individual, secili prej nesh duhet të “ruh[et] nga krenaria, që të mos bëhe[mi] si nefitët e lashtësisë”.

Më lejoni t’ju sugjeroj që, nëse ju ose unë besojmë se jemi mjaftueshëm të fortë dhe këmbëngulës për ta shmangur arrogancën e kryelartësisë, atëherë ndoshta jemi duke vuajtur

ply stated, if you or I do not believe we could be afflicted with and by pride, then we are vulnerable and in spiritual danger. In the space of not many days, weeks, months, or years, we might forfeit our spiritual birthright for far less than a mess of pottage.

If, however, you or I believe we could be afflicted with and by pride, then we consistently will do the small and simple things that will protect and help us become “as a child, submissive, meek, humble, patient, full of love, willing to submit to all things which the Lord seeth fit to inflict upon [us].” “Blessed are they who humble themselves without being compelled to be humble.”

As we follow President Benson’s counsel and ask ourselves why the Lord inspired Mormon to include in his abridgment of the book of Helaman the accounts, admonitions, and warnings that he did, I promise we will discern the applicability of these teachings to the specific conditions of our individual lives and families today. As we study and ponder this inspired record, we will be blessed with eyes to see, ears to hear, minds to comprehend, and hearts to understand the lessons we should learn to “beware of pride, lest [we should] enter into temptation.”

I joyfully witness that God the Eternal Father is our Father. Jesus Christ is His Only Begotten and Beloved Son. He is our Savior. And I testify that as we walk in the meekness of the Lord’s Spirit, we will avoid and overcome pride and have peace in Him. I so witness in the sacred name of the Lord Jesus Christ, amen.

tashmë nga kjo sëmundje vdekjeprurëse nga ana shpirtërore. E thënë thjesht: Nëse ju ose unë nuk besojmë se mund të prekemi nga kryelartësia dhe prej saj, atëherë jemi të cenueshëm dhe në rrezik shpirtëror. Në hapësirën e jo shumë ditëve, javëve, muajve ose viteve, ne mund ta humbasim të drejtën e parëbirnisë sonë shpirtërore për shumë më pak se një tas me supë.

Megjithatë, nëse ju ose unë besojmë se mund të prekemi nga kryelartësia dhe prej saj, atëherë do t’i bëjmë vazhdimisht gjërat e vogla dhe të thjeshta që do të na mbrojnë dhe do të na ndihmojnë të bëhemi “si një fëmijë, [të] nënsh-truar, [të] bindur, [të] përlur, [të] duruar, plot me dashuri, [të] gatshëm t’u nënshtrohe[mi] të gjitha gjërave që Zoti i sheh të përshtatshme të shkaktojë mbi [ne]”. “Të bekuar janë ata që përulen, pa qenë të detyruar të përulen.”

Kur e ndjekim këshillën e Presidentit Benson dhe e pyetim veten pse Zoti e frymëzoi Mormonin të përfshinte në përmbledhjen e Librit të Helamanit tregimet, porositë dhe paralajmërimet që përfshiu, ju premtoj se do ta dallojmë zbatueshmërinë e këtyre mësimëve në kushtet specifike të jetës sonë individuale dhe të familjeve tona sot. Teksa e studiojmë dhe e përsiatim këtë anal të frymëzuar, ne do të bekojemi me sy për të parë, veshë për të dëgjuar, mendje për të rrokur dhe zemër për të kuptuar mësimet që duhet të nxjerrim që të “ruh[emi] nga krenaria që të mos bie[m] në tundim”.

Dëshmoj gëzueshëm se Perëndia, Ati i Amshuar, është Ati ynë. Jezu Krishti është Biri i Tij i Vetëmlindur dhe i Dashur. Ai është Shpëtimtari ynë. Dëshmoj se, ndërsa ecim në butësinë e Shpirtit të Zotit, ne do ta shmangim dhe mposhtin kryelartësinë dhe do të kemi paqe në Të. Kështu dëshmoj, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen.